

KUJDESI PËR KAFSHËT NË RRUGË

PSE T'I NDIHMOJMË KAFSHËT NË RRUGË?

Sjellja e një kafshe është produkt i mjedisit të saj. Kafshët nën përkujdesjen e komunitetit, do të jenë të buta, të shëndetshme, dhe të dashura me njerëzit, që minimizon dukshëm gjasat për incidente apo sulme potenciale.



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve

www.animalrights-rks.org



STRAYCOCO.COM

STRAY DOG CONTROL THROUGH COOPERATION

1. SIGURONI USHQIM DHE UJË

UJË



Sigurimi i ujit të pastër për kafshët e rrugës është një nga veprimet më të mira që mund të bëni për to, pasi që kafshët e rrugës **vazhdimisht pinë ujë të ndotur nga pellgjet apo kanalizimet.**

Mundohuni të siguronit **ujë në enë balte** pasi e mban ujin të ftohtë dhe të freskët gjatë gjithë ditës. Mos harroni, uji duhet të ndërrohet një herë në çdo **6 deri në 10 orë** për **pastërti maksimale.**

USHQIM



Kafshët në rrugë detyrohen të ushqehen me mbeturinat dhe mbetjet e tjera që gjenden në rrugë ku ndodhen miliona mikroba dhe sëmundje. Por nëse u sigurohet ushqimi bazë, ato mbijetojnë për të bërë një jetë më të shëndetshme dhe më të lumtur.

Sigurohuni që t'i **ushqeni kafshët në kohë të caktuar** dhe sigurohuni që ato të jenë larg zonave me frekuentim të lartë për të shmangur konfliktet me njerëzit. Po ashtu, kufizoni sasinë e ushqimit që u jepet atyre në mënyrë që të zvogëloni varësinë e tyre nga ju.

2. DEHELMETIZIMI

Dehelmetizimi është një proces i zhdukjes së krimbave apo parazitëve në trupin e kafshës.

Dehelmetizimi mund të bëhet duke përdorur **tableta dhe shurube** që janë lehtësisht të disponueshme në klinikat veterinare.

Duhet të kontaktohet veterinari për të përcaktuar **dozën e saktë.**



3. PARANDALIMI I RRIQRAVE ME NDIHMËN E "IVERMECTIN"

Plagët e lëkurës të shkaktuara nga rriqrat mund të çojnë në infeksione tek qentë dhe macet.

Infektimet e rënda të rriqrave mund të çojnë në **anemi dhe vdekje**.

Një veprim i thjeshtë që mund të bëhet për të parandaluar rriqrat tek kafshët e rrugës është t'u jepet **një dozë e tabletave Ivermectin (10 mg) çdo muaj ose një herë në 2 muaj** gjatë periudhës kohore **mars-gusht**. Duhet të kontaktohet veterinari për të përcaktuar dozën e saktë.

VAKSINIMI DHE STERILIZIMI

Nëse veterinari e vlerëson që një kafshë e ka **moshën e përshtatshme për t'u vaksinuar**, mos hezitoni ta bëni këtë. Rekomandohet gjithashtu **sterilizimi i qenve apo maceve adoleshente**, pasi ndihmon shumë në e popullsisë së kafshëve dhe përmirëson shëndetin e tyre.

Nëse nuk ndiheni të sigurt të ndërveproni me një kafshë që duhet të vaksinohet/kastrohet, kontaktoni veterinarin ose organizatat për mbrojtjen e kafshëve.

PARANDALONI DHE RAPORTONI KEQTRAJTIMIN

Nëse hasni në abuzim me kafshë, **mos qëndroni të heshtur**. Nëse shihni dikë që rrah ose shqetëson një kafshë, kundërshtoni atë veprim dhe përpiquni të edukoni personin, duke e informuar që keqtrajtimi i kafshëve apo zhvendosja e kafshëve endacake me forcë është e **dënueshme me ligj** dhe konsiderohet **vepër penale**.

Nëse kjo nuk funksionon, **njoftoni policinë**.



GJATË VERËS



● VENDOSNI ENË ME UJË:

Vendosni sa më shumë enë me ujë në vende të përshtatshme për kafshët në rrugë.

● SHPËTONI NJË JETË:

Sigurohuni që kafshët kanë ujë dhe strehim të mjaftueshëm. Nëse gjeni një kafshë në ankth, kontaktoni një veterinar ose transportoni kafshën në klinikën më të afërt veterinare.

MERRNI MASA:

Frymëmarrja e vështirësuar dhe lëvizjet jonormale të kokës janë tregues të rraskapitjes ose të ndikimit nga nxehtësia. Hidhni shumë ujë me temperaturën e dhomës në trupin e kafshëve për t'i ftohur ato, fshini ato me një peshqir të lagur dhe telefononi një veterinar ose transportoni kafshën në klinikën më të afërt veterinare.

GJATË DIMRIT



● OFRONI STREHIM:

Nëse keni mundësi, ofroni strehim të përkohshëm për ndonjë kafshë të rrugës, sidomos gjatë natës. Nëse nuk mund të merrni një kafshë brenda në shtëpi apo banesë, së paku hapni dyert e garazhës ose të hyrjes ashtu që këto kafshë të kenë një strehë nga i ftohti.

● PËRDORNI RROBA APO BATANIJE TË VJETRA:

Nëse keni rroba apo batanije të vjetra që nuk i përdorni në shtëpi, mund t'i shfrytëzoni për t'i mbuluar kafshët.

● KRIJONI STREHIM:

Nëse nuk keni mundësi të strehoni një kafshë të rrugës, me pak punë, mund të krijoni një strehë të përkohshme të cilën mund të ndërtoni nga kutitë e drurit, kartonit, kutitë e këpucëve etj.